



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 78 Prot

Tiranë, më 16/06/2010

VENDIM Nr. 5 dt. 08.06.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 08.06.2010, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

Sipas pikave të rendit të ditës:

Lidhur me: Projekte të cilat presin financim:

1. **Miratohet:** Projekt- ide e rehabilitimit të muzeut arkeologjik të Apollonisë:
 - Rikonstrukcion i portikut të statujave në manastirin e apollonisë.
 - Sistemimi i parkingut dhe vendosja e biletarisë.**me sugjerimet:**
 - Përpara hartimit të projektit të zbatimit, të zhvillohet në vend një konsultë me specialistë të gjeologjisë, për problematikën e portikut
 - Të hartohen dy projekte zbatimi duke parashikuar sfondin pas statujave me dy variantet me gur dhe me tullë të kuqe.
2. **Miratohet:** Projekti i konservimit të ikonës së "Shën Kozmait", në DRKK Berat
3. **Miratohet:** Projekt konstruksioni i skenës së Butrintit. Miratohet investimi për largimin e ujit. Realizimi i tij do të bëhet i mundur vetëm në rast se nuk do të realizohet projekti i vënies në punë të pompës për heqjen e ujërave.
4. **Miratohet:** Ndërhyrjet konservuese në mozaikët e trikonkës, Butrint (ambjentet XXV dhe XVI).
5. **Miratohet:** Projekt restaurimi, konservimi i mozaikut në sektorin "D" në Apolloni, "Akili".
6. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesa Vaso Çuçi, Gjirokastër.

Lidhur me: Projekte të financuara UNESCO

1. **Miratohet:** Ndërhyrje kons. rest. Fjetja e Shën Mërise nr.inv. 3671 (nr. i kart. 6391)
2. **Miratohet:** Ndërhyrje kons. rest. Krishti Pantokrator ir.inv. 3676 (nr. i kart. 6539)
3. **Miratohet:** Ndërhyrje kons. rest. Shën Mëria me krishtin nr.inv. 3672 (nr.kart. 6512)
4. **Miratohet:** Ndërhyrje kons. rest. Krishti mbi fron nr.inv. 3681 (nr. kart. 6541)
5. **Miratohet:** Ndërhyrje kons. rest. Shën Nikollë nr.inv. 3694 (nr. kart. 6278)

Lidhur me: Projektet e materialit shtesë:

1. **Nuk u diskutua:** Diskutim rreth problematikës për hartimin e një projekti restaurimi për Godinën e Parlamentit të parë Shqiptar.
2. **IMK të paraqesë** propozimin e saj lidhur me kërkesën e Avokatit të familjes Mbretërore dhe Ministrisë së Brendshme, për shpalljen Monument Kulture të objektit “Varreza e Nënës Mbretëreshë”.

Lidhur me: Kërkesat për licensë:

1. **Miratohet:** Kërkesë për rinovim license e ark. Reshat Gega, për licensë personale profesionale të Kat. A/1, A/2, A/3, A/4. Të shlyhet detyrimi financiar pranë DRKK Berat.
2. **Miratohet:** Kërkesë për rinovim license e shoqërisë “GEN RED”, për licensë profesionale, shoqëri ndërtimi, për Kat. C, me drejtues teknik, Reshat Gega. Të shlyhet detyrimi financiar pranë DRKK Berat.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
FERDINAND XHAFERRAJ

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE